



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 987/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Fatbardha Reka, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Ferizajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.987/2021, i paraqitur nga Fatbardha Reka, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Ferizajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin ka kërkuar rinumërim e fletëvotimeve në vendvotimet: 2501Y/13D, 2532D/02D, 2510D/04R, 2521D/01R, 2509D/02R, për kandidatët e kuvendit komunal në Ferizajt, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

## A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, Fatbardha Reka, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Ferizajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka parashtruar apel me të cilin pretendon se pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, kandidatja në fjalë posedon 318 vota, mirëpo thekson se janë bërë gabime teknike gjatë regjistrimit të votave sepse mungojnë të dhënat për kandidatët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, në VV 2501Y/13D. Më tej në apel parashtruesja shton se në 2532D/02D, i figuron vetëm 1 votë dhe se e njëjta thekson se është e bindur 100 %, se ka fituar më shumë vota. Në Vendvotimet: 2510D/04R, 2521D/01R dhe 2509D/02R pretendon se e kanë votuar familjarët e saj dhe nga rezultati përfundimtar nuk i posedon ato vota, e njëjta mendon se është bërë ndonjë gabim teknik gjatë procesimit të votave,  
Kërkon që të rinumërohen votat në VV 2501Y/13D, 2532D/02D, 2510D/04R, 2521D/01R dhe 2509D/02R

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar.**

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, në bazë të të cilave ka kërkuar rinumërim të fletëvotimeve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtrueses së apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi deklaratat e votuesve të bashkangjitura në apel nga ana e ankueses, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme për të konkluduar se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtrueses së apelit se apelin e mbështet në pohimet e familjarëve dhe miqve të saj nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidatja ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeluasi nuk ka paraqitur ndonjë provë tjetër si Formularët e Përputhjes së Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve, të cilët do shërbenin si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Apeli i ankueses u refuzua lidhur me kërkesën për rinumërim të VV të lartcekura, pasi që sipas evidencës zyrtare të KQZ-së të gjitha fletëvotimet në këto VV, për të gjithë kandidatët janë rinumëruar dhe nuk mund të rinumërohen edhe një here.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Fatbardha Reka, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Ferizajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Ferizaj, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat apo ndonjë lëshim teknik, andaj kërkesa e apeluases për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kuvend komunal në Komunën e Ferizajt, për Subjektin Politik LVV, vlerësohet si i pa bazuar. Shkaqet për rinumërimin të fletëvotimeve në VV 2501Y/13D, 2532D/02D, 2510D/04R, 2521D/01R dhe 2509D/02R, sipas vlerësimit të panelit do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr 987/2021 më datën 07.11.2021

**Kryesuese e Panelit**

Milena Deris



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 1 të LEP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrëveshjes pranimit të këtij vendimi.